

NOTE INFORMATIVE

Tiranë, më 30.01.2023

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “shkarkim nga detyra” të magjistratit E.K.

Magjistrati E.K. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës është dënuar (më 11.10.2022) me vendim të formës së prerë me 2 vjet e 4 muaj burgim për kryerjen e veprës penale të “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, c’ka përbën “*Shkelje shumë të rëndë disiplinore*”. E.K. ka diskretituar pozitën dhe figurën e magjistratit, ka cënuar rëndë imazhin e drejtësisë dhe ka ulur besimin e publikut tek dhënia e drejtësisë.

ILD pasi ka administruar vendimin e dënimit të magjistratit E.K., ka njoftuar KLP për nisjen e hetimit disiplinor ndaj tij, me datë 28.10.2022 dhe për përfundimin e hetimit më 21.12.2022.

Më datë 02.12.2022, magjistrati E.K. ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga detyra dhe KLP më datë 19.12.2022, ka vendosur: *“1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqje për E.K.,... 2.Dorëheqja jep efekt më datë 31.01.2023...etj.”*

Bazuar në nenet 64 pika 1 shkronja “a”, 65, 139 pika 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, në lidhje me magjistratin E.K., *nuk rezultoi e provuar ekzistenca e shkaqeve ligjore, që të diktonte mbylljen e hetimit.*

Përsa më sipër, *ILD ka vendosur përfundimin e Hetimit dhe dërgimin e kërkesës për procedim disiplinor në KLP.*

Në një rast të ngjashëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor më 02.06.2021, ka mbajtur qëndrimin, se dorëheqja e magjistratit K.S. nuk përbën shkak për mbylljen e hetimit disiplinor nga ILD, si për fillimin dhe vazhdimin e procedimit disiplinor, në vijim, në Këshill, duke specifikuar se *“Këshilli ka vlerësuar dhe vlerëson se nuk mund të deklarohet mbarimi i statusit të gjyqtarit me dorëheqje, në kushtet kur ndaj tij provohet se ka filluar një hetim disiplinor dhe është dhënë një vendim gjyqësor i formës së prerë për kryerjen e një krimi.”*

Sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, më datë 16.01.2023 ka caktuar seancë dëgjimore për *procedimin disiplinor në ngarkim të magjistratit E.K. për datën 30.01.2023*, duke mos e konsideruar dorëheqjen e magjistratit E.K. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës (i caktuar nga KLP përkohësisht si Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës), si shkak për mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore.

Për pasojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, kërkon nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë: Të administrojë provat e paraqitura nga ana e ILD në këtë procedim disiplinor dhe të pranojë kërkesën e ILD për caktimin ndaj magjistratit E.K. të masës disiplinore *“Shkarkim nga detyra”* për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës dhe nga neni 104, pika 3 e ligjit nr. 96/ 2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar*”.